
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 06.05.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: “Blerje mjete transporti për rinovimin e flotës së mjeteve rrugore të Policisë së Shtetit”, e ndarë në 2 (dy) lote:

Loti 1: “Blerje Automjete me kalueshmëri të lartë SUV me naftë për Policinë e Shtetit”.

Loti 2: “Blerje Mikrobuses me min 8+1 vende për Policinë e Shtetit”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

34114200-1 Makina të policisë

34100000-8 Automjete

34113300-5 Fuoristrada

34113300-5 Minibus

Vlera e fondit limit: **448,145,591** (katërqind e dyzet e tetë milion e njëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një) **lekë pa TVSH**, ose 4,688,696.29 (katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë presje njëzet e nëntë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 06.05.2026 është 95.58 lekë.

Loti 1: “Blerje Automjete me kalueshmëri të lartë SUV me naftë për Policinë e Shtetit” me fond limit: 359,071,881 (*treqind e pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një*) lekë **pa TVSH** ose 3,756,767.95 (tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

Loti 2: “Blerje Mikrobuses me min 8+1 vende për Policinë e Shtetit” me fond limit: 89,073,710: (*tetëdhjetë e nëntë milionë e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dhjetë*) lekë **pa TVSH** ose 931,928.33 (nëntëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e njëzet e tetë pikë tridhjetë e tre) Euro pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara

sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Loti 1: “Blerje Automjete me kalueshmëri të lartë SUV me naftë për Policinë e Shtetit”.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të lotit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar *jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit të lotit* është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*”.

Në rastin konkret Njësisa e Prokurimit ka konsideruar të arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit*”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të*

tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

*i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit të lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të

provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si vërtetime/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht një servis në pronësi/me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacion si më poshtë:

- Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licencat, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.
- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Dokumentacioni i kërkuar të paraqitet në sistem.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 2 të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligji me nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma

a) të VKM me nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, VKM me nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës me nr. 1546, datë 29.3.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi, si për shitjen ashtu edhe për riparimin e mjeteve rrugore me motor, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuara për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit brenda periudhës së garancisë.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së për Lotin 1.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mjetet e kërkuara si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Është kërkuar paraqitja e çertifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore në përputhje me standartet e Bashkimit Europian. Gjithashtu çertifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për mjetet e ofruara, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë si më poshtë:

Automjetet SUV 4X4 jo më pak se 2 vjet ose 150.000 km.

Automjetet SUV 2X4 jo më pak se 3 vjet ose 120.000 km.

(Garancia të jetë e shoqëruar me normën (km) që do të ndërrohet vaji, çmimet e lubrifikantit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëvendësohen brenda afatit të garancisë).

8. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se shërbimet teknike të planifikuara do të kryhen pa pagesë për vitin e parë (kohë e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimeve mirëmbajtëse).

Argumentim për pikën 7 dhe 8: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mjetet e prokuruarat. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që automjetet prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

Kërkohet kryerja pa pagesë e shërbimeve teknike të planifikuara për vitin e parë, pasi kjo është koha e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimeve të mirëmbajtjes nga Autoriteti kontraktor përfitues.

8. Operatori ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të targuara dhe regjistruara në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (përfshire të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, siguracion dhe kolaudim).

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjetet do të dorëzohen pranë AK të pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se ofertuesi nuk plotëson këto kritere për të gjitha lotet ku ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin/lotet në të cilin oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 2: “Blerje Mikrobus me min 8+1 vende për Policinë e Shtetit”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar *jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të lotit* është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin*

e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”.

Në rastin konkret Njësisa e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontrates/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.*

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.*

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

*i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

c. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

d. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit të lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi

të tilla si vërtetime/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht një servis në pronësi/me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacion si më poshtë:

- Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licencat, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.
- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Dokumentacioni i kërkuar të paraqitet në sistem.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 2 të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligji me nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM me nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, VKM me nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të

përbashkëta”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës me nr. 1546, datë 29.3.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi, si për shitjen ashtu edhe për riparimin e mjeteve rrugore me motor, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuara për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit brenda periudhës së garancisë.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së për Lotin 2.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mjetet e kërkuara si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklaroje që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Është kërkuar paraqitja e çertifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore në përputhje me standartet e Bashkimit Europian. Gjithashtu çertifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. Operatori garancie për mjetet e ofruara, ku të jetë përcaktuar perioda e garancisë jo më pak se 3 vjet ose 150.000 km. (Garancia të jetë e shoqëruar me normën (km) që do të ndërrohet vaji, çmimet e lubrifikantit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëvendësohen brenda afatit të garancisë).

8. Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të targuara dhe regjistruara në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (përfshirë të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, siguracion dhe kolaudim).

8. Operatori ekonomik duhet të deklaroje se shërbimet teknike të planifikuara do të kryhen pa pagesë për vitin e parë (kohë e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimeve mirëmbajtëse).

Argumentim për pikën 7 dhe 8: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mjetet e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që automjetet prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

Kërkohet kryerja pa pagesë e shërbimeve teknike të planifikuara për vitin e parë, pasi kjo është koha e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimeve të mirëmbajtjes nga Autoriteti kontraktor përfitues.

8. Operatori ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të targuara dhe regjistruara në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (përfshire të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, siguracion dhe kolaudim).

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjetet do të dorëzohen pranë AK të pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se ofertuesi nuk plotëson këto kriterë për të gjitha lotet ku ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin/lotet në të cilin oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet teknike

Loti 1: “Blerje Automjete me kalueshmëri të lartë SUV me naftë për Policinë e Shtetit”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR AUTOVETURE ME KALUESHMËRI TË LARTË SUV ME TËRHEQJE 4X4

Të përgjithshme: Fuoristrade 4x4,

Lloji i automjetit:	Autoveturë e re
Modeli i karrocërisë:	SUV
Kilometra të përshkruara:	0 km
Viti i prodhimit:	Min 2026

Motori:

- Lënda djegëse	Naftë
- Fuqia motorike	Min 145 kw/195 kf - Max 220 kw/300 kf
- Vëllimi/Cilindrata	Min 2990 cm ³ - Max 3500 cm ³
- Konsumi i karburantit i kombinuar:	Max. 9 litra për 100 km.
- Numri i cilindrave	Min 4
- Klasifikimi mjedisor:	Euro 6

Transmisioni:

- Kutia e shpejtësisë (Kambio)	Automatike min 5+1 marshe
- Shpejtësia maksimale mjetit	Min 180 km/orë
- Tërheqja	4x4

Përmasat e mjetit:

- Gjatësia	Max 5050 mm
- Gjerësia pa pasqyra	Min 1950 mm
- Lartësia	Min 1920 mm
- Distanca Aksiale	Min 3000 mm
- Lartësia nga Toka	Min 220 mm

Kabina:

-Numri i dyerve	Min 5
-Numri i vendeve	Min 4+1

Sistemi i drejtimit:

- Elektrik/Hidraulik
- Timon i rregullueshëm ne krahun e majtë.

Ngjyra :

E negociushme ne momentin ë lidhjes se kontatës

Aksesorë shtesë:

- Ajër i kondicionuar
- Ekran me prekje Min. 12”
- Pasqyrat e jashtme me me rregullim elektrik
- Rregullator automatik te shpejtesise
- Sinjalizues per daljen nga korsia
- Sistemi frenimit ABS, ESP, ESC
- Xhamat e dyerve të para me komandim elektrik,

- Airbag para & anesor,
- Sinjalizues për presionin e gomave,
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete conform normave të CE
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim në distance
- Fener mjegulle,
- Sistem parkimi inteligjent
- Dritat me led

Te jetë e kompletuar me Kompletin e veglave të drejtuesit të mjetit;

1. Xhiro Makinë
2. Krik
3. Katalog Teknik i përkthyer ne gjuhe shqipe
4. Gomë rezerve normale
5. Kutitë të ndihmës së shpejtë

Kërkesa të tjera;

1. Te ofrojë mjet rrugor të kërkuar në përshkrimet e autoritetit kontraktor.
2. Mjetet rrugore që do të përfitohen nga kjo kontratë të jenë te prodhuara ne vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për perdorim në vendet e BE, (kjo të vërtetohet me certifikate origjine)
3. Mjetet te jenë të pajisura me Certificate Komformiteti COC
4. Mjetet rrugore të kenë garanci jo më pak se 2 vjet ose 150.000 km. (Garancia të jetë e shoqëruar me normën (km) që do të ndërrohet vaji, çmimet e lubrifikantit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëvendësohen brenda afatit të garancisë).
5. Afati i lëvrimit jo më shumë së 120 (njëqind e njëzetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.
6. Automjeti te dorëzohet i zhdoganuar, me detyrimet e shlyera në Organet Tatimore, i targuar dhe regjistruar ne pronësi te Drejtorisë se Përgjithshme te Policisë se Shtetit.
7. Ofertuesi te jetë i pajisur me autorizimin e prodhuesit i cili duhet te jetë pjesë e dokumenteve të tenderit.
8. Në çmim janë përfshire të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, siguracion dhe kolaudim;
9. Shërbimet teknike të planifikuara të kryhen pa pagesë per vitin e parë (kohë e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimeve mirëmbajtese).

Specifikime teknike për “Autovetura 4+1 Fuoristrade”

Lloji i autoveturës “SUV”

Lloji i automjetit:	Autoveturë e re
Modeli i karrocërisë:	SUV
Kilometra të përshkruara:	0 km
Viti i prodhimit:	Min 2026

Motori:

- | | |
|-----------------------------------|---|
| - Lënda djegëse | Naftë |
| - Numri i cilindrave | 4 cilindra |
| - Fuqia motorike | Min 100 kw/135 kf – Max 130 kw/175kf |
| - Vëllimi/Cilindrata | Min 1590 cm ³ – Max 1895 cm ³ |
| - Konsumi i karburantit per 100km | Max 7 litra/100 km |
| - Klasifikimi mjedisor: | Euro 6 |

Transmisioni:

- | | |
|--------------------------------|------------|
| - Kutia e shpejtësisë (Kambio) | Automatike |
| - Tërheqja | Min 2x4 |

Përmasat:

- | | |
|--------------------------------|-------------|
| - Gjatësia e mjetit | Min 4540 mm |
| - Gjerësia e mjetit pa pasqyra | Min 1860 mm |
| - Lartësia e mjetit | Min 1640 mm |
| - Distanca aksiale | Min 2680 mm |

Kabina:

- | | |
|---|--------------------------|
| - Numri i dyerve | 5 (pesë) |
| - Numri i vendeve (duke përfshirë dhe shoferin) | 5 (pesë) |
| - Ajër i Kondicionuar | Klima me minimumi 1 zone |
| - Xhamat e dyerve | Me komandim elektrik |
| - Mbyllje e centralizuar e dyerve | Me komandim në distancë |
| - Ngjyra | E Bardhe |

Sistemi i drejtimit:

- | | |
|-----------------------------|-------------------|
| - Timon elektrik/ hidraulik | Në krahun e majtë |
| - Komanda në timon | PO |

Sistemi i sigurisë:

- | | |
|--|-----------------|
| - Sistem frenimi (ABS) | |
| - Programi i stabilitetit elektronik (ESP) | |
| - Airbeg për shoferin dhe pasagjerët | Minimuni 6 copë |

Aksesorë;

- Çelësa me pult për mbylljen e makinës, komandim në distancë
- Vegla ndihmese (Xhel, Kompresor, Krik automjett, Xhiro makine, trekëndësh rreziku, kuti e ndihës së shpejtë)
- Tapete tekstili para dhe mbrapa
- Sensore parkimi
- Fenerët e makinës LED
- Kontroll automatik i shpejtësisë dhe distancës
- Min Radio MP3/USB, me ekran me prekje

- Sinjalizues për presionin e gomave,
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jetë konform normave te CE.
- Ngjyra e bardhe dhe e loguar sipas VKM-se nr 763, date 02.11. 2016

Kerkesa te tjera;

- Te ofrojë mjet rrugor të kërkuar në pershkrimet e autoritetit kontraktor.
- Mjetet rugore që do të perfitohen nga kjo kontratë të jenë te prodhuara në vendet e Bashkimit European ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, (kjo të vërtetohet me certifikate origine)
- Mjetet të jenë të pajisura me Certificate Komformiteti COC
- Mjetet rrugore të kenë garanci jo më pak se 3 vjet ose 120.000 km. (Garancia të jetë e shoqëruar me normën (km) që do të ndërrohet vaji, çmimet e lubrifikantit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëeëndësohen brenda afatit të garancisë).
- Afati i lëvrimit jo më shumë së 120 (Njëqind e njëzet) ditë nga nënshkrimi i kontrates.
- Automjeti të dorëzohet i zhdoganuar, me detyrimet e shlyera në Organet Tatimore, i targuar dhe regjistruar në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Ofertuesi të jetë i pajisur me autorizimin e prodhuesit i cili duhet te jetë pjesë e dokumenteve te tenderit.
- Në çmim janë përfshirë të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, siguracion dhe kolaudim;
- Shërbimet teknike të planifikuara të kryhen pa pagesë për vitin e parë (kohë e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimeve mirëmbajtese).

1. Logimi

- Ngjyra e automjetit e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema “POLICIA E SHTETIT” (2 copë) me material adhesiv fosforishent në të dy portat e para.
- Stema “POLICIA RENDIT” në qendër të kapakut të motorit dhe në pjesën e pasme të automjetit.
- Në pjesën e dytë pas stemës “POLICIA E SHTETIT” mbishkrimi “POLICIA” me ngjyrë blu fosforishente mbi sfond të bardhë.
- Numri telefonit të policisë në dy pjesët anësore të mbrapa kolpit.
- Në pjesën e pasme mbishkrimi “POLICIA” blu fosforeshente .

DIZENJIMI I MJETEVE TE POLICISE SE SHTETIT



Të gjitha matjet janë në milimetra

FUORISTRADA PER POLICINE E RENDIT FAQE NR.9

Sinjalistika; Sirena zanore dhe Fenelinë e gjate pamore profesionale për autoveturat e Policisë së Shtetit me ndriçim rrotullues anash ngjyrë blu dhe mbishkrimin në mes “POLICIA” .

Këto pajisje janë të homologuara dhe duhet të plotësojnë të gjitha parametrat teknikë të kërkuara nga normativat e BE dhe ato të Policisë së Shtetit Shqiptar, si vijon;

- Të ketë grup optik R LED (efekt rrotullues)
- Të ketë 8 LED të ushqyera nga 2 ushqyes *switching*, të cilat të jenë të montuar mbi një qark të stampuar me bazë alumini, i fiksuar në një suport të gjatë tip lavaman alumini në formë qarkore.
- Të ketë lente reflektuese (PMMA) për përhapjen dhe amplifikimin e dritës në 360 gradë.
- Të dy pjesët anësore të jenë ngjyrë blu ndërsa pjesa e mesit të jetë e bardhe me ndriçim nga brenda, i cili të jetë i komandueshëm sipas rastit me mbishkrimin “POLICIA”.
- Transmision i përbërë prej çift koronash të dhëmbëzuara.
- Moto reduktor me filtër të brendshëm kundër zhurmave.
- Llambat e ndricimit të grupit të rrotullimit të jenë tipi H1.
- Rrotullim me bronxinë të sinterizuar.
- Pasqyrë alumini e anodizuar.
- Mundësi sinkronizimi të 2 grupeve rrotulluese.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Loti 2: “Blerje Mikrobus me min 8+1 vende për Policinë e Shtetit”.

Specifikime teknike për “Autovetura 8+1“

Lloji i autoveturës:

Lloji i automjetit:	Autoveturë e re
Modeli i karrocërisë:	SUV
Kilometra të përshkruara:	0 km
Viti i prodhimit:	Min 2026

Motori:

- Lënda djegëse	Naftë.
- Fuqia motorike	Min.100 kw/135 kf– Max.133 kw/180kf
- Vëllimi/Cilindrata	Min 1990 cm ³ – Max. 2200 cm ³
- Numri i cilindrave	Min 4
- Klasifikimi mjedisor:	Euro 6
- Konsumi i karburantit per 100km	Max 8 litra/100 km

Transmisioni:

- Kutia e shpejtësisë (Kambio)	Manuale/Automatike
- Shpejtësia maksimale	Min 140 km/orë
- Tërheqja	2 x 4

Sistemi i drejtimit:

- Timon elektrik/ hidraulik	Në krahun e majtë
- Komanda në timon	Po

Përmasat:

- Gjatësia e mjetit	Min 5450 mm
- Gjerësia e mjetit pa pasqyra	Min 2030 mm
- Gjerësia e mjetit me pasqyra	Min 2280 mm
- Lartësia e mjetit	Min 1980 mm
- Distanca aksiale	Min 3500 mm

Kabina:

- Numri i dyerve	Min 4 (katër)
- Numri i vendeve (duke përfshirë dhe shoferin)	9 (nëntë)

Aksesorë

- Ajr i kondicionuar përpara dhe mbrapa
- Pasqyrat e jashtme me rregullin manual ose elektrik
- Çelsa me pult për mbylljen e makinës
- Ekran Multimedial Min 13”
- Kontroll automatik i shpejtësisë
- Tapete tekstili para dhe mbrapa

- Sensorë parkimi
- Fenerët e makinës LED
- Sistemi elektrik 12V, si dhe të jetë konform normave të CE.
- Mbyllje e centralizuar e dymve, komandim në distancë.
- Ngjyra e bardhe dhe e loguar sipas VKM-se nr 763, date 02.11. 2016

Të jetë e kompletuar me Kompletin e veglave të drejtuesit të mjetit;

1. Xhiro Makinë
2. Krik
3. Katalog Teknik i përkthyer ne gjuhe shqipe
4. Gomë rezerve normale
5. Kutitë të ndihmës së shpejtë

Kërkesa të tjera;

1. Të ofrojë mjet rrugor të kërkuar në përshkrimet e autoritetit kontraktor.
2. Mjetet rrugore që do të përfitohen nga kjo kontratë të jenë të prodhuara në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, (kjo të vërtetohet me çertifikate origjinale)
3. Mjetet të jenë të pajisura me Certifikate Komformiteti COC
4. Mjetet rrugore të kenë garanci jo më pak se 3 vjet ose 150.000 km. (Garancia të jetë e shoqëruar me normën (km) që do të ndërrohet vaji, çmimet e lubrifikantit, filtrave dhe pjesëve të këmbimit që do të zëvendësohen brenda afatit të garancisë).
5. Afati i lëvrimit jo më shumë se 120 (Njëqind e njëzet) ditë nga nënshkrimi i kontratës.
6. Automjeti të dorëzohet i zhdoganuar, me detyrimet e shlyera në Organet Tatimore, i targuar dhe regjistruar në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
7. Ofertuesi të jetë i pajisur me autorizimin e prodhuesit i cili duhet të jetë pjesë e dokumenteve të tenderit.
8. Në çmim janë përfshirë të gjitha shpenzimet doganore, regjistrimi, targat, siguracion dhe kolaudim;
9. Shërbimet teknike të planifikuara të kryhen pa pagesë për vitin e parë (kohë e nevojshme për lidhjen e kontratave të shërbimeve mirëmbajtëse).

Logimi:

- Ngjyra e automjetit e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema “POLICIA E SHETIT” (2 copë) me material adesiv fosforeshent në të dy portat e para
- Stema e “Policisë së Rendit” në qendër të kapakut të motorit dhe në pjesën e pasme para mbishkrimit “POLICIA”.
- Shirita blu në pjesët anësore që fillojnë nga kufiri i portës së parë dhe përfundojnë në pjesën e pasme në kufi me portën e bagazhit.
- Në pjesët anësore me ngjyrë blu mbishkrimi “POLICIA”.
- Numri telefonit të policisë në dy pjesët anësore të mbrapa kolpit.
- Në pjesën e pasme sipër targës mbishkrimi “POLICIA” me ngjyrë blu fosforeshente.

**DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHTETIT**



Te gjitha matjet janë në milimetra.

MINIBUS PER POLICINE E RENDIT FAQE NR.8

Sinjalistika; Sirena zanore dhe Fenelinë pamore e gjate, profesionale për autoveturat e Policisë së Shtetit me ndriçim rrotullues anash ngjyrë blu dhe mbishkrimin në mes “POLICIA”.

Këto pajisje janë të homologuara dhe duhet të plotësojnë të gjitha parametrat teknikë të kërkuara nga normativat e BE dhe ato të Policisë së Shtetit Shqiptar, si vijon;

- Të ketë grup optik R LED (efekt rrotullues)
- Të ketë 8 LED të ushqyera nga 2 ushqyes *switching*, të cilat të jenë të montuar mbi një qark të stampuar me bazë alumini, i fiksuar në një suport të gjatë tip lavaman alumini në formë qarkore.
- Të ketë lente reflektuese (PMMA) për përhapjen dhe amplifikimin e dritës në 360 gradë.
- Të dy pjesët anësore të jenë ngjyrë blu ndërsa pjesa e mesit të jetë e bardhe me ndriçim nga brenda, i cili të jetë i komandueshëm sipas rastit me mbishkrimin “POLICIA”.
- Transmision i përbërë prej çift koronash të dhëmbëzuara.
- Motoreduktor me filtër të brendshëm kundër zhurmave.
- Llambat e ndricimit të grupit të rrotullimit të jenë tipi H1.
- Rrotullim me bronxinë të sinterizuar.
- Pasqyrë alumini e anodizuar.
- Mundësi sinkronizimi të 2 grupeve rrotulluese.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili ndër të tjera argumenton *“me qëllim shfrytëzimin sa me racional të tyre referuar destinacionit ku do perdoren, duke mbajtur parasysh raportin midis kapaciteteve sipas destinacionit, fuqisë motorike, konsumit të karburantit, si dhe përmasave gabarite të tyre ka përgatitur specifikimet teknike më optimale të mundshme”*.

Pas eksplorimit të tregut dhe informacioneve në internet, referuar destinacionit që do të përdoren këto mjete, grupi i punës gjykoj që me fondet buxhetore të parashikuara për Policinë e Shtetit të prokurohen këto mjete sipas specifikimeve teknike.

Pas njohjes me Urdhrin e Drejtorit të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse nr. 02, datë 14.01.2026. grupi i punës, me qëllim plotësimin e nevojave për automjete për rinovimin e flotës së mjeteve të transportit, pasi beri një alialize të sasisë dhe gjendjes teknike të mjeteve të inventarit që kanë strukturat e Policisë së Shtetit duke e krahasuar edhe me numrin limit të mjeteve të miratuara, përcaktoi llojin dhe specifikimet teknike të mjeteve që do të llogaritet dhe vlera e kontratës.

Grupi i punës për “Blerje mjete transporti për rinovimin e flotës së mjeteve rrugore të Policisë së Shtetit”, në hartimin e specifikimeve teknike, dhe përcaktimin e llojit të mjeteve që do të prokurohen ka vlerësuar nevojën e ngutshme të përmirësimit të kapaciteteve logjistike për strukturat e Policisë së Shtetit.

Në organikën e miratuar të mjeteve të Policisë së Shtetit grupi i punës që përgatiti këtë organikë i përbërë nga drejtues të lartë dhe specialistë të fushës, bazuar në misionin që ka policia në përmbushjen e misionit të saj e bazuar edhe në strukturën organike të burimeve njerëzore, kërkesat e vazhdueshme të njëjësive shpenzuese, ka gjykuar që strukturave të Policisë së Shtetit i nevojiten gjithsej 2045 mjete të ndryshme transporti.

Mjetet rrugore të amortizuara dhe në punë janë mbi 50% e mjeteve kryesisht të viteve 2000-2015, të përfituara nga blerje me fondet e shtetit, donacione të ndryshme dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara. Kilometrat e përshkruara për këtë kategori mjetesh variojnë nga 200.000 km deri në 500.000 km. Më të amortizuarat janë grup mjetet e llojit fuoristrada dhe mikrobus kjo edhe për arsye të angazhimeve të shumta që kanë pasur dhe kanë strukturat e Policisë së Shtetit në terrene malore e kodrinore për të luftuar përveç krimit edhe kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike.

Situata e gjendjes së mjeteve por edhe performanca që duhet të ketë policia e Shtetit lidhur me nivelin e krimit dhe kryesisht të krimit të organizuar e bëjnë të domosdoshme nevojën për rinovimin e flotës me mjete të reja dhe të tekriologjisë bashkë kohore për t'ju përgjigjur krimit në të gjitha nivelet.

Pa u futur në rolin dhe rëndësinë e mjeteve të transportit të çdo niveli policie suksesin në përfundimin e çdo aksioni policor e ka të lidhur me llojin dhe gjendjen teknike të mjeteve të transportit, prezantimi që iu bë më sipër gjendjes teknike dhe të performancës së mjeteve na ndihmon të kuptojmë se sa e nevojshme është rinovimi i flotës së mjeteve të transportit rrugor.

Objektivi i përgjithshëm i këtij prokurimi është Kompletimi dhe Modernizimi i strukturave të Policisë së Shtetit me mjete transporti, rritja e nivelit të sigurisë publike dhe performancës së punës së punonjësve të policisë duke lëvizur me mjete rrugore bashkëkohorë për parandalimin dhe / ose zbardhjen e ngjarjeve.

Përmbajtja e këtij projekti është vlerësimi i të gjithë faktorëve si social ashtu dhe ekonomik duke vlerësuar shtrirjen gjeografike, madhësinë e popullsisë dhe problematikat e territorit që mbulon, plan vendosjen, numrin e punonjësve për çdo strukturë, nevojat dhe shërbimet më të domosdoshme për praninë e Policisë së Shtetit.

Investimi në këtë projekt synon arritjen e objektivave:

- 1. Rritja e fuqisë goditëse ndaj krimeve te niveleve te ndryshme*
- 2. Rritja e parametrave të Rendit dhe Sigurisë në komunitet;*
- 3. Rritjen e integritetit të punonjësve të Policisë;*
- 4. Rritjen e sigurisë në punë të punonjësve të Policisë;*
- 5. Rritja e performancës të punonjësve të policisë duke u përfaqësuar denjësisht para opinionit publik;*
- 6. Parandalimi, zbulimi dhe goditjen e çdo veprimtarie kriminale, në mbrojtje të pronës, jetës dhe garantimin e sigurisë publike;*
- 7. Përmirësimi i kushteve të punës së punonjësve të Policisë;*

Përveç rezultateve do të ndryshojë edhe morali i punonjësve të policisë në detyrë.

Nisur sa më sipër; për nevojat operacionale dhe mbështetëse të strukturave policore bëhet e domosdoshme rifreskimi dhe furnizimi i ri me mjete me kalueshmëri të lartë dhe mikrobus, si pjesë e rëndësishme e Policisë së Shtetit .

Grupi i punës bazuar në situatën aktuale dhe funksionalitetin e pritshëm të shërbimit që do të kryejnë këto mjete bëri eksplorimin e tregut vendas në distributorë që tregtojnë dhe kryejnë aktivitetin e tyre në Shqipëri, për mjetet që nevojiten, si dhe nga kërkimi në internet në faqet që reklamojnë prodhimet e mjeteve me kalueshmëri të lartë dhe mikrobus.

Me qëllim shfrytëzimin sa me racional të tyre referuar destinacionit ku do përdoren, duke mbajtur parasysh raportin midis kapaciteteve sipas destinacionit, fuqisë motorike, konsumit të karburantit, si dhe përmasave gabarite të tyre ka përgatitur bashkëlidhur specifikimet teknike me optimale të mundshme.

Pas eksplorimit të tregut dhe informacioneve në internet, referuar destinacionit që do të përdoren këto mjete, grupi i punës gjykoj që me fondet buxhetore të parashikuara për Policinë e

Shtetit, në PBA-në e viteve 2026-2028 në zërin “Blerje mjete transporti për rinovimin e flotës së mjeteve rrugore të Policisë së Shtetit”, të prokurohet për mjetet objekt prokurimi.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin.

NJËSIA E PROKURIMIT